

7 qershor, 2026

DEKLARATË PRELIMINARE

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 7 qershor – Të qeta dhe konkurruese, por në një klimë të lodhjes zgjedhore që u reflektua në pjesëmarrje të ulët qytetare

Prishtinë, 9 qershor 2026

PËRMBLEDHJE E GJETJEVE KRYESORE

Koalicioni i organizatave për vëzhgimin e zgjedhjeve “Demokracia në Veprim” (DnV) vlerëson se zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 7 qershorit 2026 u zhvilluan përgjithësisht në përputhje me standardet demokratike për zgjedhje të lira, konkurruese dhe të qeta. Procesi zgjedhor u administrua në mënyrë profesionale dhe efikase, ndërsa votuesit patën mundësi të ushtrorjnë të drejtën e tyre të votës në mënyrë të lirë dhe të barabartë.

Zgjedhjet u mbajtën në një kontekst të pazakontë politik dhe institucional, duke përbërë procesin e tretë zgjedhor në nivel vendi brenda një periudhe prej rreth gjashtëmbëdhjetë muajsh. Ky cikël i vazhdueshëm zgjedhor ishte pasojë e pamundësisë së akterëve politikë për të ndërtuar institucione stabile dhe për të siguruar konsensusin minimal të nevojshëm për funksionimin normal të sistemit institucional. Në krahasim me proceset e fundit zgjedhore, fushata dhe Dita e Zgjedhjeve u karakterizuan nga një lodhje zgjedhore e manifestuar në riciklim të ofertave të kaluara politike dhe në ulje të motivimit qytetar për pjesëmarrje në zgjedhjes.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve administroi shumicën dërrmuese të operacioneve zgjedhore në mënyrë profesionale dhe brenda afateve të parapara. Ndryshe nga disa procese të mëhershme zgjedhore, puna e KQZ-së u karakterizua nga më pak përplasje politike dhe një proces vendimmarrës më funksional. Organizimi i votimit brenda dhe jashtë Kosovës, përgatitjet teknike për Ditën e Zgjedhjeve, si dhe komunikimi publik me votuesit, u realizuan përgjithësisht në mënyrë efektive. Megjithatë, në disa raste KQZ ndërmoi veprime që tejkalonin bazën ligjore ekzistuese, veçanërisht përmes disa dispozitave të miratuara në Rregulloren për Vëzhguesit e Zgjedhjeve dhe vendimit për lejimin e identifikimit të votuesve jashtë Kosovës me dokumente të skaduara, i cili më pas u anulua nga PZAP.

Votimi jashtë Kosovës u zhvillua pa probleme serioze dhe pa debatet politike që kishin karakterizuar procese të mëhershme. Interesimi i diasporës mbeti i lartë, me mbi 131 mijë votues të regjistruar dhe me pjesëmarrje mbi 82% në votimin fizik në përfaqësitë diplomatike. Administrimi i këtij segmenti të procesit ishte përgjithësisht efektiv. Megjithatë, publikimi në rrjete sociale i fotografive dhe videove që shfaqnin fletëvotime të plotësuar vazhdon të ngrejë shqetësime lidhur me fshehtësinë e votës dhe integritetin e votimit jashtë Kosovës.

Fushata zgjedhore u zhvillua në një ambient konkurrues dhe përgjithësisht të qetë. Subjektet politike patën mundësi të zhvillojnë aktivitetet e tyre dhe të komunikojnë lirshëm me votuesit në të gjithë territorin e vendit. Diskursi politik ishte më i moderuar krahasuar me disa procese të mëhershme zgjedhore dhe nuk u shoqërua me incidente serioze. Megjithatë, barazia e garës mbeti një nga shqetësimet kryesore të evidentuara gjatë kësaj periudhe. Vendimet e Qeverisë në detyrë për ndarjen e pagesave të njëhershme financiare për kategori të ndryshme të qytetarëve dhe subvencionimin e linjave ajrore për mërgatën në prag të zgjedhjeve krijuan ndikim në ambientin zgjedhor dhe cenonin perceptimin e barazisë së garës ndërmjet konkurrentëve politikë.

7 qershor, 2026

Mediat luajtën rol të rëndësishëm në informimin e qytetarëve gjatë periudhës zgjedhore dhe ofruan hapësirë për prezantimin e qëndrimeve të subjekteve politike. Megjithatë, raportimi dhe debatet publike shpesh u fokusuan më shumë në dinamikën e garës dhe retorikën politike sesa në analizimin e programeve dhe politikave konkrete të propozuara nga garuesit. Njëkohësisht, fushata zgjedhore vazhdoi të zhvendoset në masë të konsiderueshme në hapësirën digjitale, ku rrjetet sociale shërbyen si një nga kanalet kryesore të komunikimit politik. Përdorimi intensiv i përmbajtjeve të sponsorizuara dhe materialeve video konfirmoi rëndësinë në rritje të platformave online në garën zgjedhore, por njëkohësisht evidentoi vazhdimin e sfidave që lidhen me dezinformimin dhe shpërndarjen e informacionit të paverifikuar.

Oferta politike u fokusua kryesisht në çështje ekonomike dhe sociale, ndërsa debati publik shpesh dominohej nga mesazhe politike dhe slogane elektorale më shumë sesa nga diskutime të detajuara mbi politikën publike dhe realizueshmërinë e tyre. Fushata mbeti kryesisht e përqendruar rreth liderëve partiakë, ndërsa gratë vazhduan të jenë dukshëm më pak të përfaqësuara në debatet publike dhe hapësirën mediatike sesa në listat zgjedhore.

Dita e Zgjedhjeve u zhvillua në atmosferë të qetë dhe pa incidente serioze që do të mund të cenonin integritetin e procesit. Hapja, votimi dhe mbyllja e vendotimeve u administruan përgjithësisht në mënyrë të rregullt. Megjithatë, një nga problemet më të shprehura gjatë ditës mbeti vështirësia e votuesve për të gjetur vendvotimin e saktë, fenomen i evidentuar në një numër të konsiderueshëm vendvotimesh. Po ashtu, sfidë vazhdon të mbetet qasja e personave me aftësi të kufizuara në qendrat e votimit, si dhe rastet e fotografimit të fletëvotimeve dhe zbatimi jo gjithmonë i njëtrajtshëm i disa procedurave zgjedhore.

Një zhvillim veçanërisht pozitiv i këtyre zgjedhjeve ishte rënia e ndjeshme e votimit me asistencë. Të dhënat e DnV-së tregojnë se zbatimi më i rreptë i rregullave për këtë formë votimi ka ndikuar dukshëm në uljen e rasteve të evidentuara krahasuar me proceset e mëparshme zgjedhore, duke kontribuar në mbrojtjen e integritetit të votës.

Mekanizmat e drejtësisë zgjedhore funksionuan në mënyrë efektive gjatë tërë procesit. PZAP dhe Gjykata Supreme trajtuan ankesat dhe kontestet zgjedhore në afatet e parapara ligjore dhe demonstuan nivel të lartë profesionalizmi dhe konsistence në vendimmarrje. Krahas tyre, Prokuroria dhe Policia e Kosovës luajtën rol aktiv në trajtimin e rasteve të dyshuara për shkelje të të drejtave zgjedhore dhe në ruajtjen e integritetit të procesit.

Në përgjithësi, DnV vlerëson se zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 7 qershorit 2026 u zhvilluan në një ambient demokratik, konkurrues dhe të qetë. Administrimi i procesit zgjedhor ishte përgjithësisht profesional, ndërsa institucionet përgjegjëse arritën të menaxhojnë me sukses shumicën e sfidave organizative dhe procedurale. Megjithatë, përdorimi i masave me ndikim elektorale nga institucionet publike, vështirësitë e vazhdueshme në orientimin e votuesve, pengesat në qasjen për personat me aftësi të kufizuara dhe disa mangësi në zbatimin e procedurave zgjedhore mbeten çështje që kërkojnë adresim në proceset e ardhshme zgjedhore.

7 qershor, 2026

Konteksti politik dhe zgjedhor

Zgjedhjet parlamentare të 7 qershorit 2026 u mbajtën në një kontekst të pazakontë politik dhe institucional, duke shënuar procesin e tretë zgjedhor në nivel vendi brenda një periudhe prej rreth gjashtëmbëdhjetë muajsh. Mbajtja e zgjedhjeve të njëpasnjëshme në një interval të shkurtër pasqyron vështirësitë e vazhdueshme të skenës politike për të ndërtuar institucione stabile dhe për të siguruar nivelin minimal të konsensusit të nevojshëm për funksionimin normal të sistemit institucional, sidomos atij parlamentar.

Përpjekjet për tejkalimin e krizës përmes zgjedhjeve të jashtëzakonshme të dhjetorit 2025 prodhuan vetëm zgjidhje të përkohshme. Ndonëse ato mundësuan krijimin e institucioneve të reja – përkatësisht konstituimit të Kuvendit dhe zgjedhjes së Qeverisë – mungesa e bashkëpunimit politik dhe raportet e brishta ndërmjet forcave parlamentare vazhduan të kufizojnë funksionalitetin institucional. Kriza kulmoi me dështimin e Kuvendit për zgjedhjen e Presidentit të Republikës brenda afateve kushtetuese, duke çuar në shpërndarjen e Kuvendit dhe shpalljen e zgjedhjeve të reja parlamentare.

Gjatë kësaj periudhe, Gjykata Kushtetuese kishte rol të drejtpërdrejtë në jetën politike dhe institucionale të vendit. Përmes një sërë vendimesh dhe interpretimeve kushtetuese, ajo u thirr vazhdimisht për të sqaruar çështje që lidhen me konstituimin e institucioneve, procedurat parlamentare dhe zbatimin e dispozitave kushtetuese. Nevoja e vazhdueshme për ndërhyrje të Gjykatës reflektoi jo vetëm kompleksitetin e situatës politike, por edhe mungesën e vullnetit të akterëve politikë për të gjetur zgjidhje përmes dialogut dhe kompromisit politik.

Në krahasim me proceset e mëparshme zgjedhore, zgjedhjet e 7 qershorit u karakterizuan me nivel dukshëm më të ulët mobilizimi politik dhe qytetar. Vëzhgimet e DnV-së tregojnë se fushata zgjedhore u karakterizua nga pjesëmarrje më e kufizuar në aktivitete publike, interesim më i ulët i qytetarëve dhe një perceptim i përgjithshëm se zgjedhjet - më shumë sesa do sillnin një cikël të ri politik dhe tejkalim të bllokadave, do të prodhonin vazhdimësi të krizës politike. Kjo u reflektua edhe në nivelin e pjesëmarrjes në votime, i cili ishte dukshëm më i ulët krahasuar me zgjedhjet parlamentare të mbajtura vetëm gjashtë muaj më parë.

Njëkohësisht, procesi zgjedhor u zhvillua në një ambient ku çështjet që lidhen me integritetin e administrimit zgjedhor vazhdojnë të mbeten pjesë e debatit publik. Vonesat në procesimin dhe certifikimin e rezultateve në zgjedhjet paraprake, problemet e evidentuara gjatë numërimit të votave të kandidatëve, si dhe hetimet dhe kontestet që kanë shoqëruar procese të ndryshme zgjedhore gjatë vitit të kaluar, kanë rritur nivelin e vëmendjes publike ndaj administrimit të zgjedhjeve dhe transparencës së procedurave zgjedhore.

Në këto rrethana, rëndësia e zhvillimit të një procesi zgjedhor të besueshëm, transparent dhe të administruar në mënyrë profesionale ishte veçanërisht e lartë. Përtej garës për përfaqësim politik, këto zgjedhje u panë si një mundësi për rikthimin e stabilitetit institucional dhe forcimin e besimit të qytetarëve në proceset demokratike dhe institucionet publike.

Korniza ligjore

Zgjedhjet parlamentare të 7 qershorit 2026 u zhvilluan mbi të njëjtën kornizë ligjore që ishte zbatuar edhe në zgjedhjet e mëparshme parlamentare, pa ndryshime në legjisllacionin primar zgjedhor. Sistemi zgjedhor, procedurat kryesore të administrimit të zgjedhjeve dhe mekanizmat për mbrojtjen e të drejtës së votës mbetën të pandryshuara.

7 qershor, 2026

Megjithatë, gjatë periudhës para zgjedhjeve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve miratoi ndryshime dhe plotësime në katër rregullore zgjedhore, që kishin të bënin me votimin jashtë Kosovës, administrimin e Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve, procedurat e votimit dhe numërimit në vendvotime, si dhe rregullimin e vëzhgimit të zgjedhjeve.

Shumica e ndryshimeve kishin karakter teknik dhe synonin përshtatjen e procedurave me përvojat e proceseve të fundit zgjedhore. Megjithatë, DnV vlerëson se disa dispozita të përfshira në Rregulloren Zgjedhore Nr. 04/2026 për Vëzhguesit e Zgjedhjeve kanë probleme dhe mangësi serioze sa i përket ushtrimit të vëzhgimit të pavarur të zgjedhjeve.

Rregullorja e re, në tejkalim të autorizimeve ligjore, zgjeroi ndjeshëm dokumentacionin dhe informacionin që kërkohet nga organizatat e shoqërisë civile për qëllime të akreditimit, ndërsa njëkohësisht i dha KQZ-së kompetenca të reja vlerësuese që nuk burojnë qartë nga Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme. Për më tepër, disa dispozita krijuan mundësi për kufizime të panevojshme në procesin e akreditimit të organizatave vëzhguese, që si të tilla paraqesin elemente mjaft problematike lidhur me sigurinë juridike dhe parashikueshmërinë e procesit.

Puna e trupave menaxhuese të zgjedhjeve

Administrimi i zgjedhjeve parlamentare të 7 qershorit 2026 u karakterizua nga një nivel më i lartë i stabilitetit dhe efikasitetit institucional krahasuar me proceset e fundit zgjedhore. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) arriti të realizojë shumicën dërrmuese të operacioneve zgjedhore brenda afateve të parapara dhe pa probleme serioze, duke përfshirë përgatitjen e listës së votuesve, certifikimin e subjekteve politike dhe kandidatëve, organizimin e votimit brenda dhe jashtë vendit, emërimin e stafit zgjedhor, si dhe përgatitjet teknike për Ditën e Zgjedhjeve dhe publikimin e rezultateve online.

Ndryshe nga proceset e mëhershme zgjedhore, puna e KQZ-së gjatë kësaj periudhe u karakterizua nga më pak përplasje politike dhe një proces vendimmarrës përgjithësisht më funksional dhe konsensual. Shumica e vendimeve u miratuan pa kontestime të mëdha politike, duke kontribuar në krijimin e një ambienti më të qëndrueshëm për administrimin e procesit zgjedhor. KQZ gjithashtu vazhdoi të avancojë komunikimin publik dhe informimin e votuesve përmes platformave digjitale dhe rrjeteve sociale, duke rritur qasjen e qytetarëve në informacionet zgjedhore.

Megjithatë, gjatë kësaj periudhe janë evidentuar edhe disa çështje që ngritën shqetësime lidhur me respektimin e kufijve të mandatit ligjor të institucionit. Në prag të zgjedhjeve, KQZ miratoi ndryshime në disa rregullore zgjedhore, përfshirë Rregulloren për Vëzhguesit e Zgjedhjeve. Disa nga dispozitat e miratuara zgjeruan kriteret dhe kërkesat për akreditimin e organizatave vëzhguese përtej atyre të përcaktuara në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, duke ngritur shqetësime lidhur me sigurinë juridike dhe ushtrimit të vëzhgimit të pavarur të zgjedhjeve.

Po ashtu, KQZ miratoi një vendim që do t'u mundësonte votuesve jashtë Kosovës të identifikoheshin me dokumente të identifikimit të skaduar gjatë procesit të votimit. Ky vendim, pas ankesës së Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), u anulua më pas nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i cili konstatoi se një dispozitë e tillë nuk mbështetej në kornizën ligjore në fuqi.

Një çështje e pazgjidhur mbetet edhe funksionalizimi i plotë i administratës zgjedhore në komunat veriore të vendit. Edhe gjatë këtij procesi zgjedhor, KQZ nuk ka arritur të emërojë Zyrtarë Ekzekutivë Komunalë Zgjedhorë në katër komunat veriore, duke vazhduar praktikën e mbulimit të këtyre pozitave përmes zyrtarëve të institucioneve tjera publike. Ndonëse kjo zgjidhje ka mundësuar realizimin e

7 qershor, 2026

operacioneve zgjedhore, ajo nuk paraqet zgjidhje afatgjatë për administrimin e zgjedhjeve në këto komuna.

DnV vlerëson se, në përgjithësi, KQZ ka administruar procesin zgjedhor në mënyrë profesionale dhe ka realizuar me sukses shumicën e obligimeve të saj kushtetuese dhe ligjore. Megjithatë, respektimi strikt i kufijve të kompetencave ligjore, garantimi i standardeve të njëjta për të gjithë akterët e procesit dhe forcimi i mëtejshmë i transparencës institucionale mbeten fusha ku nevojiten përmirësime të mëtejshme.

Procesi i votimit jashtë vendit

Votimi jashtë Kosovës vazhdon të përbëjë një komponent të rëndësishëm të procesit zgjedhor në Kosovë, duke reflektuar interesimin e lartë të diasporës për pjesëmarrje në jetën politike të vendit. Për zgjedhjet parlamentare të 7 qershorit 2026, procesi i regjistrimit të votuesve jashtë Kosovës përfundoi me 131,800 votues të regjistruar, nga mbi 142 mijë aplikime të pranuar nga KQZ – që është numri më i lartë i aplikimeve të pranuar ndonjëherë. Nga numri i përgjithshëm i votuesve të regjistruar, 100,522 janë regjistruar për votim përmes postës në kutitë postare jashtë Kosovës, 3,502 për votim përmes kutisë postare të KQZ-së në Kosovë, ndërsa 27,776 votues janë regjistruar për votim fizik në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Kosovës.

Për dallim nga proceset paraprake, votimi jashtë vendit nuk u shoqërua me debate të mëdha politike apo konteste të vazhdueshme lidhur me organizimin e tij. KQZ realizoi në afat procesin e regjistrimit të votuesve, përgatitjen e listave përfundimtare dhe shpërndarjen e fletëvotimeve për votuesit e regjistruar për votim me postë. Sipas të dhënave zyrtare, pothuajse të gjitha dërgesat e planifikuara janë adresuar brenda afateve të parapara, duke mundësuar që votuesit të kenë kohë të mjaftueshme për të ushtruar të drejtën e tyre të votës.

Një nga çështjet kryesore juridike që shoqëroi këtë segment të procesit kishte të bënte me vendimin e KQZ-së për lejimin e identifikimit të votuesve me dokumente të identifikimit të skaduara. Pas ankesës së paraqitur në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ky vendim u anulua, duke rikthyer zbatimin e standardeve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Votimi fizik në përfaqësitë diplomatike u zhvillua më 6 qershor 2026 dhe, sipas raporteve publike, ai u administrua në mënyrë të rregullt dhe pa incidente serioze që do të mund të cenonin integritetin e procesit. Nga 27,776 votues të regjistruar për këtë formë votimi, 22,860 e ushtruan të drejtën e votës, që përfaqëson një pjesëmarrje prej 82.46%. Procesi u zhvillua në mënyrë të qetë dhe në përputhje me procedurat e parapara.

Megjithatë, gjatë periudhës së votimit jashtë Kosovës janë evidentuar raste të publikimit në rrjetet sociale të fotografive dhe videove që shfaqnin fletëvotime të plotësuar. Në disa raste, materialet e publikuara kanë ngritur dyshime edhe për mundësinë e ndikimit ose organizimit të votimit. Ndonëse përgjegjësia për vlerësimin e këtyre rasteve u takon institucioneve kompetente, praktika të tilla vazhdojnë të ngrenë shqetësime lidhur me ruajtjen e fshehtësisë së votës dhe integritetin e procesit të votimit jashtë Kosovës.

Në përgjithësi, DnV vlerëson se votimi jashtë Kosovës është administruar në mënyrë efektive dhe se shumica e operacioneve zgjedhore janë realizuar në përputhje me afatet dhe procedurat e parapara. Megjithatë, forcimi i mekanizmave që garantojnë fshehtësinë e votës dhe adresimi i shqetësimeve që lidhen me publikimin e fletëvotimeve mbeten sfida që kërkojnë vëmendje edhe në proceset e ardhshme zgjedhore.

7 qershor, 2026

Fushata zgjedhore

Fushata zgjedhore për zgjedhjet parlamentare të 7 qershorit 2026 u zhvillua në një ambient konkurrues dhe përgjithësisht të qetë, duke u mundësuar subjekteve politike që të zhvillojnë aktivitetet e tyre dhe të prezantojnë programet para qytetarëve. Në krahasim me proceset e fundit zgjedhore, fushata u karakterizua nga një nivel më i ulët mobilizimi qytetar dhe pjesëmarrje më e kufizuar në aktivitetet politike, duke reflektuar në masë të caktuar lodhjen e elektoratit pas një serie procesesh zgjedhore të njëpasnjëshme.

Pavarësisht zhvillimit të rregullt të aktiviteteve zgjedhore dhe mungesës së incidenteve serioze, çështja e barazisë së garës ishte një nga shqetësimet kryesore të evidentuara gjatë kësaj periudhe. DnV vlerëson se vendimet i Qeverisë në detyrë për ndarjen e pagesave të njëhershme financiare për kategori të ndryshme të qytetarëve, dhe vendimi për subvencionim të linjave ajrore, vetëm pak kohë para zgjedhjeve, krijoi ndikim të drejtpërdrejtë në ambientin zgjedhor dhe cenoi perceptimin e barazisë së garës ndërmjet konkurrentëve politikë. Vendime të tilla, të marra në prag të zgjedhjeve dhe me implikime të konsiderueshme financiare, krijojnë avantazh për subjektet që ushtrojnë pushtetin dhe rrezikojnë të zbehin kufirin ndërmjet politikave publike dhe interesit elektor.

Oferta politike gjatë kësaj gare zgjedhore u përqendrua kryesisht në çështje ekonomike dhe sociale. Premtimet për rritjen e pagave, pensione, mbështetjen sociale, investimet infrastrukturore dhe zhvillimin ekonomik dominuan komunikimin publik të shumicës së subjekteve politike. Megjithatë, në shumë raste munguan sqarimet konkrete lidhur me koston financiare të zotimeve, burimet e financimit dhe afatet apo planet e zbatimit të tyre. Si rezultat, debati publik shpesh u përqendrua më shumë në mesazhe politike dhe slogane elektorale sesa në diskutime të detajuara rreth politikave publike.

Një tipar tjetër i kësaj fushate ishte dominimi i liderëve partiakë dhe kandidatëve për poste ekzekutive në komunikimin publik. Aktivitetet zgjedhore u fokusuan kryesisht në tubime të mëdha elektorale, ndërsa takimet më të vogla me qytetarët dhe format e dialogut të drejtpërdrejtë ishin më pak të pranishme. Kjo kufizoi mundësinë për diskutime më substanciale rreth prioritetëve të qytetarëve dhe për prezantimin më të gjerë të kandidatëve individualë.

Diskursi politik ishte përgjithësisht më i moderuar krahasuar me disa prej zgjedhjeve të mëparshme. Megjithatë, nuk munguan rastet e gjuhës nxitëse, etiketuese, sulmeve personale dhe retorikës polarizuese ndërmjet akterëve politikë. Po ashtu, DnV evidentoi raste të përfshirjes së fëmijëve në aktivitete promovuese të subjekteve politike, praktikë që mbetet e papërshtatshme dhe në kundërshtim me parimin e mbrojtjes së interesit më të mirë të fëmijës.

Rrjetet sociale vazhduan të luajnë rol të rëndësishëm në komunikimin politik dhe promovimin e aktiviteteve zgjedhore. Monitorimi i DnV-së evidentoi përdorim intensiv të reklamimit të sponsorizuar nga subjektet politike dhe kandidatët individualë, si dhe një rritje të përdorimit të përmbajtjeve video dhe formateve të avancuara të komunikimit digjital. Megjithatë, ashtu si në proceset e fundit zgjedhore, platformat digjitale vazhduan të shërbejnë edhe si kanal për përhapjen e dezinformatave dhe informacioneve të paverifikuara, duke ndikuar negativisht në cilësinë e debatit publik.

DnV ka monitoruar detajisht shpenzimet e subjekteve politike dhe kandidatëve gjatë periudhës zgjedhore për promovimin e aktiviteteve të tyre në rrjete sociale, kryesisht në platformën Meta. DnV poashtu do të monitorojë se si këto shpenzime priten të reflektohen në raportet financiare të subjekteve politike pas zgjedhjeve. Janë monitoruar rreth 500 profile në rrjetet sociale, përfshirë profilet zyrtare të partive kryesore politike (LVV, PDK, LDK, AAK dhe PSD), të gjithë kandidatët e tyre, si dhe kandidatët e dy subjekteve politike nga komuniteti serb. Vetëm gjatë javës së fundit të fushatës janë evidentuar shpenzime për sponsorizim në vlerë prej mbi 100,000 euro.

7 qershor, 2026

Hapësira digjitale vazhdoi të shërbejë jo vetëm si kanal i komunikimit politik, por edhe si mjedis ku u evidentuan raste të dezinformimit, gjuhës denigruese dhe përmbajtjeve polarizuese. Ndonëse këto raste nuk dominuan diskursin e përgjithshëm të fushatës, ato treguan edhe një herë tjetër që platformat online mbeten hapësirë ku standardet e debatit publik janë më të vështira për t'u monitoruar dhe adresuar sesa në mediat tradicionale.

Në përgjithësi, mediat u ofruan subjekteve politike mundësi të gjera për të prezantuar programet dhe qëndrimet e tyre gjatë periudhës zgjedhore. Debatet, intervistat dhe format e tjera të raportimit kontribuan në informimin e qytetarëve dhe në rritjen e transparencës së garës zgjedhore. Monitorimi i DnV-së nuk evidentoi kufizime sistematike në qasjen e subjekteve politike në mediat kryesore.

Megjithatë, një mangësi e dukshme e kësaj fushate ishte mungesa e përballjeve të drejtpërdrejta ndërmjet kandidatëve për kryeministër. Kjo kufizoi mundësinë e qytetarëve për të krahasuar alternativat politike përmes debatit të drejtpërdrejtë dhe për të vlerësuar më qartë qëndrimet e konkurrentëve për çështjet kryesore të interesit publik.

Sa i përket përfaqësimit, gratë përbënin rreth një të tretën e kandidatëve për deputetë, duke tejkaluar pragun minimal ligjor. Megjithatë, monitorimi i fushatës tregoi se prania e tyre në debatet televizive, panelet publike dhe hapësirën mediatike mbeti dukshëm më e ulët krahasuar me burrat, duke dëshmuar se përfaqësimi formal në lista zgjedhore nuk përkthehet domosdoshmërisht në pjesëmarrje të barabartë në diskursin publik.

Në përgjithësi, DnV vlerëson se fushata zgjedhore u zhvillua në një ambient të qetë dhe konkurrues, ku subjektet politike patën mundësi të komunikojnë lirisht me votuesit. Megjithatë, përdorimi i masave me ndikim elektoral nga institucionet publike, mungesa e debatit më substancial mbi politikën publike dhe vazhdimi i praktikave problematike në hapësirën digjitale mbeten sfida që ndikojnë në cilësinë e garës demokratike.

Dita e Zgjedhjeve – Votimi dhe faza e parë pas mbylljes së vendotimeve

Demokracia në Veprim vëzhgoi Ditën e Zgjedhjeve përmes 500 vëzhguesve të shpërndarë në 500 vendvotime, të përzgjedhura sipas mostrës përfaqësuese të rastësishme. Gjatë gjithë ditës, vëzhguesit raportuan mbi hapjen e vendotimeve, zhvillimin e procesit të votimit, respektimin e procedurave, qasjen e votuesve, fshehtësinë e votës dhe mbylljen e vendotimeve.

Në përgjithësi, procesi i votimit më 7 qershor 2026 u zhvillua në atmosferë të qetë dhe pa incidente serioze që do të mund të cenonin integritetin e përgjithshëm të zgjedhjeve. Votuesit patën mundësi të ushtronjë të drejtën e tyre të votës në mënyrë të lirë dhe të barabartë, ndërsa parregullsitë e evidentuara gjatë ditës ishin kryesisht të natyrës procedurale dhe teknike.

Hapja e vendotimeve u realizua përgjithësisht me kohë. Vetëm 1.6% e vendotimeve u hapën me vonesë, kryesisht për shkak të mungesës së komisionerëve apo problemeve me pajisjet zgjedhore. Megjithatë, në 2% të vendotimeve u raportuan probleme me funksionalizimin ose vendosjen e kamerave, të cilat në raste të caktuara mund të krijonin shqetësime lidhur me fshehtësinë e votës. Po ashtu, në 16% të vendotimeve nuk kishte asnjë grua komisionere, duke treguar se përfaqësimi gjinor në administrimin e vendotimeve mbetet i pabalancuar.

7 qershor, 2026

Një nga problemet më të shprehura gjatë ditës ishte vështirësia e votuesve për të gjetur vendvotimin e saktë. Deri në përmbyllje të procesit, raste të tilla u evidentuan në rreth dy të tretat e vendvotimeve, ndonëse në shumicën e tyre numri i rasteve ishte i kufizuar. Në 54% të vendvotimeve u raportuan deri në 10 raste, ndërsa në 11% të vendvotimeve u raportuan 11 deri në 30 raste. Kjo tregon se, pavarësisht informimit paraprak nga KQZ dhe mundësisë për verifikim online të qendrës së votimit, orientimi i votuesve vazhdon të mbetet sfidë praktike në Ditën e Zgjedhjeve.

Dalja e votuesve ishte dukshëm më e ulët krahasuar me proceset e fundit parlamentare. Sipas të dhënave të DnV-së, pjesëmarrja në votime deri në mbylljen e vendvotimeve ishte rreth 37%, pa përfshirë votat me kusht dhe votat jashtë Kosovës. Për krahasim, në zgjedhjet parlamentare të 28 dhjetorit 2025 dalja ishte rreth 45%, ndërsa në zgjedhjet e 9 shkurtit 2025 ishte 44.1%. Kjo rënie e pjesëmarrjes konfirmon nivelin më të ulët të mobilizimit qytetar dhe lodhjen zgjedhore të evidentuar edhe gjatë fushatës.

Një zhvillim pozitiv i këtyre zgjedhjeve ishte rënia e ndjeshme e votimit me asistencë. Gjatë ditës, votimi me asistencë u evidentua në përmasa shumë më të ulëta se në proceset e mëparshme zgjedhore, ndërsa zbatimi më i rreptë i rregullave nga komisionerët duket se ka ndikuar në kufizimin e keqpërdorimeve të mundshme. Në 66.8% të vendvotimeve komisionerët kanë kërkuar dokumente mjekësore ose prova tjera në deri në 10 raste, ndërsa në 36.8% të vendvotimeve ka pasur raste kur votuesve nuk u është lejuar votimi me asistencë në mungesë të dokumentacionit përkatës. Megjithatë, janë evidentuar edhe raste kur votimi me asistencë nuk është regjistruar në Librin e Votimit, edhe pse këto raste kanë qenë të kufizuara.

Në krahasim me zgjedhjet e mëhershme, rastet e qëndrimit të më shumë se një votuesi prapa kabinës së votimit kanë qenë relativisht të kufizuara, por jo të papërfillshme. Raste të tilla janë raportuar në 15.8% të vendvotimeve, kryesisht në numër të vogël. Po ashtu, gjatë ditës janë raportuar 39 raste të fotografimit të fletëvotimit, çka vazhdon të mbetet shqetësim për fshehtësinë e votës dhe mundësinë e presionit apo ndikimit mbi votuesit.

Gjatë procesit janë evidentuar edhe raste të identifikimit të votuesve me dokumente të Kosovës me afat të skaduar. Raste të tilla janë raportuar në 28.6% të vendvotimeve, kryesisht në numër të kufizuar. Kjo tregon se zbatimi i rregullave për identifikimin e votuesve nuk ka qenë plotësisht i njëtrajtshëm në të gjitha vendvotimet.

Qasja fizike në qendrat e votimit mbetet sfidë për një pjesë të qytetarëve. Sipas vëzhguesve të DnV-së, rreth 19% e qendrave të votimit nuk ofronin kushte të përshtatshme për qasje të lehtë për personat me aftësi të kufizuara fizike, duke kufizuar mundësinë e tyre për të votuar në mënyrë të pavarur dhe me dinjitet.

Mbyllja e vendvotimeve u zhvillua përgjithësisht në mënyrë të rregullt. Në 93.2% të vendvotimeve, mbyllja u bë ndërmjet orës 19:00 dhe 19:15, ndërsa vetëm në raste të izoluara mbyllja u raportua para orës 19:00 ose pas orës 19:15. Në vendvotimet ku kishte qytetarë në radhë në momentin e mbylljes, votuesit në përgjithësi u lejuan të ushtronin të drejtën e tyre të votës.

Në përgjithësi, DnV vlerëson se Dita e Zgjedhjeve u zhvillua në mënyrë të qetë, të rregullt dhe pa incidente serioze. Megjithatë, vështirësitë e votuesve për gjetjen e vendvotimit, problemet e përsëritura me qasjen për personat me aftësi të kufizuara, rastet e fotografimit të votës dhe zbatimi jo gjithmonë i

7 qershor, 2026

njëtrajtshëm i procedurave zgjedhore tregojnë se administrimi i votimit në nivel vendvotimi ende kërkon përmirësime të mëtejshme.

Drejtësia zgjedhore

Mekanizmat për trajtimin e ankesave zgjedhore funksionuan në përputhje me afatet dhe procedurat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Gjatë periudhës zgjedhore, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) dhe Gjykata Supreme ofruan mjete efektive juridike për subjektet politike dhe palët tjera, duke kontribuar në sigurinë juridike dhe integritetin e procesit zgjedhor.

Deri më 5 qershor 2026, PZAP kishte pranuar gjithsej 17 ankesa që lidheshin me aktivitetet e fushatës zgjedhore. Nga këto raste, janë nxjerrë 9 vendime, prej të cilave 5 aprovuese dhe 4 refuzuese. Struktura e ankesave ka qenë e larmishme dhe ka përfshirë pretendime për përdorimin e fëmijëve në fushatë, vendosjen e materialeve zgjedhore në hapësira publike, nxitjen e urrejtjes, përdorimin e resurseve publike, organizimin e aktiviteteve politike pa njoftim paraprak dhe shkelje të rregullave në afërsi të qendrave të votimit.

Për shkeljet e konstatuara të Kodit të Etikës, PZAP shqiptoi gjoha në vlerë prej 12,100 euro – një shumë që reflekton trendët pozitive të përmirësimit të sjelljes së akterëve politik. Pjesa më e madhe e tyre lidhej me përfshirjen e fëmijëve në aktivitetet e fushatës zgjedhore, praktikë që vazhdon të mbetet shqetësuese për mbrojtjen e interesit më të mirë të fëmijës dhe respektimin e standardeve të garës demokratike.

DnV vlerëson se PZAP dhe Gjykata Supreme kanë demonstruar nivel të lartë profesionalizmi dhe konsistence në trajtimin e çështjeve zgjedhore. Vendimet janë marrë brenda afateve të parapara ligjore dhe, në përgjithësi, kanë reflektuar interpretim të qëndrueshëm të dispozitave ligjore. Krahasuar me disa procese të mëhershme zgjedhore, nuk janë evidentuar mospërputhje të theksuara në praktikën vendimmarrëse apo raste që do të krijonin pasiguri juridike për pjesëmarrësit në proces.

Përveç PZAP-së dhe Gjykatës Supreme, rol të rëndësishëm në mbrojtjen e integritetit të procesit kanë luajtur edhe Prokuroria dhe organet e rendit. Gjatë periudhës zgjedhore janë trajtuar një numër rastesh që lidhen me dyshime për vepra penale kundër të drejtave zgjedhore, përfshirë pretendime për cenim të vullnetit të lirë të votuesve dhe forma të tjera të ndikimit të paligjshëm në procesin zgjedhor. Në Ditën e Zgjedhjeve, angazhimi i një numri të madh prokurorësh dhe koordinimi me Policinë e Kosovës kontribuan në reagimin e shpejtë ndaj rasteve të raportuara dhe në ruajtjen e besimit publik në proces.

Në përgjithësi, DnV vlerëson se sistemi i drejtësisë zgjedhore ka funksionuar në mënyrë efektive gjatë këtij procesi zgjedhor. Qasja profesionale e institucioneve përgjegjëse, respektimi i afateve procedurale dhe efektiviteti e mjeteve juridike kanë kontribuar në zgjidhjen e kontesteve zgjedhore dhe në forcimin e besimit në ligjshmërinë e procesit.

ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PËR KUVENDIN E KOSOVËS

7 qershor, 2026

Koalicioni i organizatave vendore të shoqërisë civile për vëzhgimin e zgjedhjeve "Demokracia në Veprim" ka angazhuar rreth 750 vullnetarë për të vëzhguar në procesin zgjedhor për zgjedhjet e parakohshme parlamentare, të 7 qershorit 2026.

DnV ka monitoruar edhe mbledhjet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Komisioneve Komunale Zgjedhore. Në ditën e zgjedhjeve, DnV ka pasur të angazhuar mbi 600 vullnetarë, prej të cilëve 500 janë vendosur nëpër vendvotime sipas metodologjisë PVT, si dhe 50 vëzhgues të tjerë në cilësi të ekipeve mobile duke përcjellë atmosferën e përgjithshme në Qendrat e Votimit dhe jashtë tyre. Ndërsa, rreth 50 vullnetarë të tjerë janë angazhuar në Qendrën e të Dhënave, përmes së cilës DNV ka mbledhur, procesuar dhe analizuar të dhënat e marra nga terreni.

DnV do të vëzhgojë edhe procesin e numërimit në Qendrat Komunale të Numërimit, përmes 100 vëzhguesve në terren, si dhe ekipeve të jursitëve dhe ekspertëve që do të analizojnë të dhënat e pranuar. Po ashtu, DnV do të vëzhgojë edhe funksionimin e QNR-së dhe procedurave të administruara aty.

Gjetjet e detajuara nga procesi i vëzhgimit para, gjatë dhe pas ditës së zgjedhjeve, do të paraqiten në raportin përfundimtar të vëzhgimit, i cili do të publikohet pas certifikimi të rezultateve.

DnV është e përkushtuar të kontribuojë në rritjen e integritetit të procesit zgjedhor përmes vëzhgimit dhe raportimit të rregullt, të paanshëm dhe objektiv tek publiku. Misioni vendor i DnV-së për monitorimin e zgjedhjeve është mbështetur nga Ambasada e Zvicrës, si dhe Ambasada Suedeze në Kosovë.